



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2019

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbajtur, më 30.05.2019)*

**Pika 1 e rendit të ditës me objekt:** Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datave 19.04.2019, 24.04.2019, 03.05.2019, 20.05.2019 dhe 23.05.2019.

*Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.*

*Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:35 dhe mbaroi në orën 12:00.*

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Maksim Qoku* (zëvendëskryetar)
3. *Medi Bici* (anëtar)
4. *Fatmira Luli* (anëtare)
5. *Brunilda Kadi* (anëtare)
6. *Dritan Hallunaj* (anëtar)
7. *Ilir Toska* (anëtar)
8. *Alban Toro* (anëtar)
9. *Brikena Ukperaj* (anëtar)
10. *Erjon Muharremaj* (anëtar)
11. *Marçela Shehu* (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtoreshë e Kabinetit pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë institucionit.*
- 5. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë institucionit.*
- 6. Valbona Bako, Specialiste pranë institucionit.*
- 7. Elis Kuçi, Specialist pranë institucionit.*
- 8. Edlira Bako, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 9. Marjana Papa, OSCE.*
- 10. Armand Sokoli, KSHH.*
- 11. Gregor Borgowski, EURALIUS.*
- 12. Klodian Rado, EURALIUS.*
- 13. Valbona Bala (Pajo), USAID.*
- 14. Charles Ericksen, USAID.*
- 15. Ervin Karamuço, ISP.*

#### **RENDI I DITËS:**

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datave 19.04.2019, 24.04.2019, 03.05.2019, 20.05.2019 dhe 23.05.2019.

*Naureda Llagami:* Atëherë, përshëndetje!

Po fillojmë mbledhjen e datës 30 maj.

Të pranishëm janë të gjithë anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Sikurse jeni në dijeni me rendin e ditës, sot kemi 4 çështje për të diskutuar dhe për të shqyrtuar në këtë mbledhje. Në fakt, gjej vend që të japë edhe pak sqarim lidhur me

disa kërkesa të bëra nga aktorë të tjerë për sa i përket respektimit të afatit 7-ditor për njoftimin e mbledhjeve.

Këshilli, në situatën që po punon është në një situatë në të cilën po zhvillon mbledhje përditë. Që do të thotë që, anëtarët e Këshillit janë duke punuar vetë, në mënyrë të përditshme lidhur me projekt-aktet që bëjnë dhe jemi në kushte pamundësie që t'i njoftojmë dhe të marrim parasysh njoftimet për 7 ditë. Për sa kohë Këshilli vepron dhe mbledhet çdo javë, tregon që i kemi mundësitë që të bëjmë një njoftim 7-ditor sepse Këshilli është duke punuar në kushte emergjente.

Çdo merak që mund të keni lidhur me njoftimin e rendit të ditës, sjell në dijeni që të na mirëkuptoni, në kushtet që ne veprojmë si Këshill.

Këshilli aktualisht është duke zhvilluar mbledhje çdo javë dhe është një punë kolosale, ku vetë anëtarët po punojnë dhe komisionet përkatëse po punojnë çdo javë dhe është shumë e rëndësishme që neve të jemi efektiv ndaj punës sonë se sa në respektimin e njoftimeve dhe afateve, për të cilat në peshën e punës që bëjmë nuk e kanë rëndësinë e duhur. Në një situatë kur Këshilli të kthehet në normalitet, pa diskutim që njoftimet, jo vetëm të rendit të ditës por edhe të projekt-akteve, do bëhen brenda afateve që ligji kërkon.

Ju sjell në vëmendje që gjatë gjithë hartimit të projekt-akteve Këshilli ka një qasje, që i nënshtron këto projekt-akte si në konsultim të brendshëm ndërmjet njëri-tjetrit, po ashtu me dy misionet që janë të atashuar pranë Këshillit, po gjithashtu edhe me të gjithë gjykatat, që janë le të themi edhe aktorët më të interesuar për vendimmarrjet tona.

Atëherë, kalojmë në rendin e ditës.

Sikurse ju kam vënë në dijeni, janë 4 çështje për rend dite.

Çështja e parë lidhet me miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datave 19.04.2019, 24.04.2019, 03.05.2019, 20.05.2019 dhe 23.05.2019.

Jeni dakord me miratimin e procesverbaleve?

Kalojmë në votim?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

*Dritan Hallunaj*: Pro.

*Illir Toska*: Dakord.

*Alban Toro*: Dakord.

*Fatmira Luli*: Pro.

*Marçela Shehu*: Dakord.

*Erjon Muharremaj*: Pro.

*Brikena Ukperaj*: Pro.

*Medi Bici*: Pro.

*Naureda Llagami*: Dakord.

Këshilli vendosi miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datave 19.04.2019, 24.04.2019, 03.05.2019, 20.05.2019, 23.05.2019. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi dhe publikimin e këtyre procesverbaleve Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 1 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2019

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbajtur, më 30.05.2019)*

**Pika 2 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për kalendarin e gjyqimit të çështjeve në gjykatën e apelit”, përgatitur nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:35 dhe mbaroi në orën 12:00.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Illir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
10. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)
11. ***Marçela Shehu*** (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Helena Papa, Drejtoreshë e Kabinetit pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Pjerin Prendi, Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
4. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë institucionit.*
5. *Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë institucionit.*
6. *Valbona Bako, Specialiste pranë institucionit.*
7. *Elis Kuçi, Specialist pranë institucionit.*
8. *Edlira Bako, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
9. *Marjana Papa, OSCE.*
10. *Armand Sokoli, KSHH.*
11. *Gregor Borgowski, EURALIUS.*
12. *Klodian Rado, EURALIUS.*
13. *Valbona Bala (Pajo), USAID.*
14. *Charles Ericksen, USAID.*
15. *Ervin Karamuço, ISP.*

#### **RENDI I DITËS:**

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për kalendarin e gjykimit të çështjeve në gjykatën e apelit”, përgatitur nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës.

*Naureda Llagami:* Kalojmë tek projekt-vendimi, pra tek çështja e dytë e rendit të ditës e cila ka të bëjë me një projekt-akt, konkretisht projekt-akti lidhur me shqyrtimin e projektvendimit “Për kalendarin e shqyrtimeve të çështjeve në Gjykatën e Apelit”, i përgatitur nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës. Ky projektvendim përcakton rregulla të hollësishme lidhur me kalendarin e gjykimit të çështjeve në gjykatën e apelit në respektim të ndryshimeve të bëra së fundmi në ligjin nr. 38/2017 në Kodin e Procedurës Civile dhe konkretisht në nenin 460 të tij, në të cilin bëhet fjalë për shqyrtimin e çështjes në apel. Në këtë dispozitë theksohet që relatori i çështjes caktohet

me short dhe është ai që cakton datën dhe orën e gjykimit në përputhje me kalendarin e shqyrtimit të çështjeve, duke respektuar radhën e ardhjes së dosjes në gjykatë dhe lejon që palët mund të kërkojnë me shkrim relatorit një përshpejtim të shqyrtimit të çështjes për disa shkaqe të vlerësuara si të rënda dhe të motivuara, - thotë dispozita. Gjithashtu, në këtë dispozitë, legjislatori ka ngarkuar Këshillin e Lartë Gjyqësor me detyrimin për të përcaktuar rregulla të hollësishme për zbatimin e këtij neni.

Për më shumë detaje, fjalën për relatimin e projekt-aktit ia jap kryetarit të Komisionit për Zhvillimin e Karrierës, zotit Ilir Toska.

***Ilir Toska:*** Faleminderit!

Atëherë, si Komision kemi përgatitur një projektvendim lidhur me kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në gjykatën e apelit. Ky është një detyrim që na përcakton neni 460 i Kodit të Procedurës Civile, referuar të cilit, duhet të përcaktojmë rregulla të hollësishme lidhur me shqyrtimin e çështjeve në gjykatën e apelit, veçanërisht sa i përket kërkesave për përshpejtim të paraqitura nga palët. Në draftin që kemi paraqitur, që kemi propozuar, jemi munduar të paraqesim në tërësi rastet dhe rrethanat mbi të cilat gjyqtari relator në gjykatën e apelit duhet të konsiderojë në rastin e paraqitjes së kërkesave për shpejtim; mënyrën se si ai duhet të veprojë në këto raste. Është një listë referuese por jo shteruese e rasteve sepse e kemi të pamundur të bëjmë një listë shteruese, gjithsesi kemi dhënë edhe një rregullim të përgjithshëm kur gjyqtari ka diskrecionin të vlerësojë rast pas rasti një kërkesë edhe përtej atyre rasteve që ne kemi listuar në mënyrë referuese.

Për përgatitjen e këtij propozimi kemi kërkuar ndihmën e EURALIUS-it. Kemi marrë sugjerime nga gjykatat e apelit, nga disa kryetarë gjykatash dhe gjyqtarë të këtyre gjykatave. Jemi përpjekur të reflektojmë çdo shqetësim apo sugjerim të tyre, për aq sa ne kemi konsideruar që ato vijnë në përputhje me ligjin apo me perceptimin tonë se si duhet të funksionojë i gjithë ky proces, veçanërisht sa i përket kërkesave për përshpejtimin e shqyrtimit të çështjeve në gjykatën e apelit.

Vlen të theksohet se për momentin, në gjykatat e apelit, ka një numër të lartë kërkesash menjëherë pas miratimit të ligjit, ndryshimit të bërë në Kodin e Procedurës Civile, ndërkohë që pas këtij vendimi, ajo që mund të anonçojmë është se do të rritet më

tej ky numër kërkesash dhe gjyqtarët në një farë mënyre do të kenë një ngarkesë tjetër shtesë sepse do duhet të vlerësojnë edhe këto kërkesa.

Në propozimin tonë janë shkruar në mënyrë të hollësishme gjithçka që ne kemi menduar që duhet të gjejë reflektim në vendimin e Këshillit. Nuk di nëse ndonjë nga anëtarët e Këshillit ka pyetje apo ndonjë sugjerim për dispozitat, formulime konkrete. Jemi përpjekur që të reflektojmë gjithçka, qoftë nga sa gjyqtarët kanë sugjeruar, ashtu edhe nga bisedat që kemi pasur me anëtarët e tjerë të Këshillit. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Atëherë, kemi diskutime dhe sugjerime lidhur me projekt-aktin?

Pra, dëshiroj edhe një herë të theksoj se është një nga projekt-aktet të cilës i është nënshtruar shumë konsultimit të hapur. Kemi marrë kontributin e të gjithë aktorëve për hartimin e tij. Edhe brenda nesh besoj. Kemi bërë disa herë diskutime për të nxjerrë një projekt-akt i cili adreson të gjithë nevojat e gjyqësorit në këndvështrime të ndryshme, si në pjesën e gjykatës ashtu edhe në pjesën e përdoruesit të gjykatës. Unë ju ftoj për miratimin e projekt-aktit.

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Pro.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Këshilli miratoi projektvendimin, vendimin “Për kalendarin e gjykimit të çështjeve në gjykatën e apelit”, sipas propozimit të bërë nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.



\* \* \*

(Pika 2 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2019

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbajtur, më 30.05.2019)*

**Pika 3 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve të drejtësisë për të mitur”, përgatitur nga Komisioni i Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:35 dhe mbaroi në orën 12:00.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ilir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
10. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)
11. ***Marçela Shehu*** (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Helena Papa, Drejtoreshë e Kabinetit pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Pjerin Prendi, Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
4. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë institucionit.*
5. *Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë institucionit.*
6. *Valbona Bako, Specialiste pranë institucionit.*
7. *Elis Kuçi, Specialist pranë institucionit.*
8. *Edlira Bako, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
9. *Marjana Papa, OSCE.*
10. *Armand Sokoli, KSHH.*
11. *Gregor Borgowski, EURALIUS.*
12. *Klodian Rado, EURALIUS.*
13. *Valbona Bala (Pajo), USAID.*
14. *Charles Ericksen, USAID.*
15. *Ervin Karamuço, ISP.*

#### **RENDI I DITËS:**

3. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve të drejtësisë për të mitur”, përgatitur nga Komisioni i Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

*Naureda Llagami:* Kalojmë tek çështja e tretë e rendit të ditës. Në fakt çështja e tretë e rendit të ditës ka të bëjë me shqyrtimin e projekt-udhëzimit “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve të drejtësisë për të mitur”, projekt-akti i cili është përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

Dua të theksoj që me miratimin e ligjit nr. 37/2017 lidhur me Kodin e Drejtësisë për të Mitur, i cili ka hyrë në fuqi më datë 01.01.2018, ka filluar zbatimin e një sërë rregullash të tjera të posaçme procedurale, në lidhje me përgjegjësinë penale të të miturit.

Një nga qëllimet e këtij Kodi ka qenë edhe rritja e përgjegjshmërisë dhe profesionalizmit të organeve kompetente në administrimin e çështjeve të Drejtësisë Penale për të Mitur.

Sipas dispozitave të parashikuara në këtë Kod është shprehur që: *“I mituri në konflikt me ligjin do të gjykohet nga seksionet për të mitur, të krijuara në gjykatat e rretheve gjyqësore, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë.”* – Neni 23 i ligjit 98/2016. Të njëjtat seksione duhet të gjykojnë sipas ligjit edhe të pandehurit e rritur që akuzohen për kryerjen e veprave penale ndaj të miturve si viktimë. Ky projekt-udhëzim i propozuar do të zbatohet në gjykatat e shkallës së parë dhe të apelit. Më shumë detaje lidhur me përmbajtjen dhe arsyen e inicimit të këtij projekt-akti, po ia kaloj fjalën kryetares së Komisionit për Vlerësimin e Etikës, zonjës Ukperaj.

***Brikena Ukperaj:*** Faleminderit, zonja Kryetare.

Shkak për inicimin e këtij udhëzimi është bërë në fakt një mospërputhje që ekziston sot midis situatës faktike se si administrohen çështjet penale me të miturit me atë çfarë parashikon kuadri ligjor. Me ndryshimet e para të Kodit të Procedurës Penale është parashikuar neni 13/4 që tashmë gjykimi i çështjeve për të mitur duhet të bëhet nga seksione të cilat caktohen sipas ligjit.

Me hyrjen në fuqi të këtyre ndryshimeve, dekreti i Presidentit që deri në atë kohë prodhonte pasoja për mënyrën se si ishte shpërndarë kompetenca lëndore në gjykatat e shkallës së parë për gjykimin e çështjeve me të mitur, mbetej pa asnjë fuqi juridike. Ndërkohë gjykatat vazhdonin të gjykonin çështjet penale me të mitur sipas seksioneve të krijuara në bazë të këtij dekreti.

Para ndryshimeve të Kodit të Procedurës Penale, në fakt kishte hyrë në fuqi në nëntor të vitit 2016 edhe ligji “Për organizimin e pushtetit gjyqësor” që përcaktonte që gjykimet e çështjeve të specializuara sikundër që kishin të bënin me çështje për të mitur, duhet të kryheshin nga seksione që ngriheshin nëpër gjykata me së paku 6 gjyqtarë. Për shkak të mungesës së Këshillave në gjykata dhe për shkak të numrit të reduktuar të gjyqtarëve në gjykatave, jo të gjitha gjykatat kishin seksione të çështjeve penale që gjykonin çështje penale me të mitur dhe bëhet fjalë këtu për çështje penale të të miturit në konflikt me ligjin apo të miturit viktimë nga vepra penale.

Në 1 janar 2018 hyn në fuqi Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur dhe sanksionon parimin e rëndësishëm që i mituri duhet të gjykohet nga gjyqtar i specializuar, qoftë ky gjyqtar i seksionit ose një gjyqtar tjetër i specializuar në rast se për shkak të numrit të gjyqtarëve brenda një gjykate të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm apo të apelit me juridiksion të përgjithshëm nuk do ishte e mundur që të realizohej ngritja e seksioneve me 6 gjyqtarë.

Këshillat e Gjykatave sot i kemi të ngritur në të gjitha gjykatat. Aktualisht kemi miratuar dhe mbledhjen për funksionimin e Këshillave të Gjykatës kështu që jemi në udhëzimin e parë që u drejtohet këtyre Këshillave të Gjykatave për të reaguar dhe për të ndryshuar këtë situatë faktike në përputhje me atë çfarë parashikojnë normat ligjore. Pra udhëzimi detyrues për të gjitha gjykatat cakton/udhëzon Këshillat e Gjykatave që, në gjykatat e shkallës së parë dhe të apelit të juridiksionit të përgjithshëm duhet të caktohen së paku 3 gjyqtarë, për gjykimin e çështjeve penale me të mitur në konflikt me ligjin ose të mitur viktimë nga vepra penale, nëse për shkak të numrit të gjyqtarëve në këto gjykata nuk mund të krijohen për gjykimin e këtyre çështjeve seksione të specializuara me së paku 6 gjyqtarë. Kur numri i gjyqtarëve në gjykatat e shkallës së parë dhe ato të apelit të juridiksionit të përgjithshëm është më i vogël apo i barabartë me 3, të tre gjyqtarët duhet të caktohen për gjykimin e çështjeve penale me të mitur në konflikt me ligjin ose të mitur viktimë nga vepra penale. Theksoj këtu, kemi përcaktuar numrin 3, për arsye sepse në procedurën penale së paku kemi tre faza të ndryshme ku gjyqtarët duhet të jenë të ndryshëm për shqyrtimin e çështjeve; Këto gjyqtarë, me qëllim specializimin, duhet të ndjekin programet e trajnimeve vazhduese në fushën e Drejtësisë Penale për të Mitur dhe; lista e gjyqtarëve që do të caktohet nga Këshillat e Gjykatave duhet t'i bëhet e ditur Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Shkollës së Magjistraturës, me qëllim përditësimin e listës së gjyqtarëve që do të trajnohen në këtë fushë dhe që do t'i nënshtrohen specializimit të tyre të vazhdueshëm.

Nga situata faktike, konkretisht na ka rezultuar që një numër i konsiderueshëm gjyqtarësh e ndjekin trajnimin pranë Shkollës së Magjistraturës dhe nuk janë vetëm gjyqtarët që sot aktualisht gjykojnë çështjet penale me të mitur të përqendruar vetëm në 6 gjykata në rang republike. Duke qenë se ka edhe gjyqtarë të gjykatave të tjera,

pothuajse të të gjitha gjykatave, sipas relacionit dhe evidentimit që është bërë edhe në materialin bashkëngjitur, janë nënshtruar trajnimit vazhdues, është e këshillueshme që pikërisht këta gjyqtarë të caktohen për gjykimin e çështjeve penale me të mitur.

Ky udhëzim ka qenë i nevojshëm për shkak se në vlerësimin tonë është një mekanizëm reagues ndaj detyrave të lëna për Shqipërinë edhe në raport progresin e përgatitur nga misioni i Bashkimit Evropian, me qëllim përmirësimin e mekanizmave institucional për sa i përket mbrojtjes së të miturve për vitet 2018-2019; kemi vlerësuar që nuk përbën ndërhyrje në veprimtarinë gjyqësore, përkundrazi i shërben mirë administrimit të drejtësisë penale për të miturit dhe rritjes së përgjegjshmërisë dhe profesionalizmit të organeve kompetente në administrimin e çështjeve të drejtësisë penale për të mitur; garanton shqyrtimin pa vonesë dhe me përparësi të këtyre çështjeve, me qëllim që drejtësia për të mitur të jepet sa më afër vendbanimit të tij, dhe i mituri të mos pengohet në aktivitetet e tij mësimore, jetësore etj., dhe njëkohësisht mundëson dhe lehtësimin e të drejtave procedurale për të miturit, në kushtet kur sot një i mitur nga një rreth i largët, për shembull marrë Tropojën apo Kukësin, detyrohet që të udhëtojë/të shkojë në Shkodër për t'u gjykuar, ndërkohë që në qoftë se gjyqtari i specializuar do të ndodhet pranë vendbanimit të tij, nuk ka asnjë pengesë ligjore që çështja penale të gjykohet nga ky gjyqtar.

Ky udhëzim vjen në përputhje edhe me frymën që është mbajtur nga kolegji penal. Doja ta theksoja këtë që, për shkak të mungesës së gjyqtarëve të specializuar, çështjet herë-herë midis gjykatave janë vënë konflikt kompetence për të cilat është shprehur Gjykata e Lartë. Gjykata e Lartë ka mbajtur qëndrimin që në një çështje, vendimi i të cilit është... përcaktohet edhe në relacion që, për sa kohë në kohën e shqyrtimit të mosmarrëveshjes njëra gjykatë nuk provonte që të kishte seksion për të mitur dhe gjyqtarë të specializuar dhe gjykata tjetër kishte, duhet të gjykohen çështja nga kjo gjykatë, nga gjykata pra që kishte seksion.

Në këtë kuadër, sanksionohet edhe një herë në këtë vendim që i mituri duhet të gjykohet shpejt dhe duhet të gjykohet nga një gjyqtar i specializuar. Në kushtet kur ne do të arrijmë të kemi në të gjitha gjykatat, në mos seksione, gjyqtarë të specializuar,

atëherë nuk do të ketë probleme dhe mendoj që do të jetë më efikase, menaxhimi i çështjes do jetë edhe në përputhje me parimet e Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.

Lidhur me Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, për shkak të karakterit unik dhe organizimit që është tërësisht i profilit penal, të gjithë gjyqtarët, sipas informacionit të kryetarit të gjykatës, gjykojnë të pandehur që janë të mitur apo në çështje ku të miturit janë viktima të veprës penale. Të gjithë ata i janë nënshtruar sesioneve trajnuese të Shkollës së Magjistraturës. Prandaj, ky udhëzim nuk është i zbatueshëm për ta, pra zbatohet vetëm në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm dhe në ato të apelit në juridiksionin e përgjithshëm.

**Naureda Llagami:** Atëherë, kemi ndonjë koment, sugjerim për projekt-udhëzimin e propozuar nga Komisioni përkatës? Po, apo jo?

Jo!

Atëherë, kalojmë projekt-aktin në votim?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Illir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Pro.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli i Lartë Gjyqësor miratoi udhëzimin mbi caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve të drejtësisë për të mitur, sipas propozimit të bërë nga Komisioni përkatës, Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

\* \* \*

(Pika 3 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2019

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbajtur, më 30.05.2019)*

**Pika 4 e rendit të ditës me objekt:** Të tjera – Shqyrtimi i projektvendimit për një ndryshim në vendimin nr. 12, datë 18.01.2019 “Për miratimin e strukturës organizative të administratës së këshillit të lartë gjyqësor”, i ndryshuar.

*Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.*

*Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:35 dhe mbaroi në orën 12:00.*

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                             |                          |
|-----------------------------|--------------------------|
| <b>1. Naureda Llagami</b>   | <b>(kryetare)</b>        |
| <b>2. Maksim Qoku</b>       | <b>(zëvendëskryetar)</b> |
| <b>3. Medi Bici</b>         | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>4. Fatmira Luli</b>      | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>5. Brunilda Kadi</b>     | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>6. Dritan Hallunaj</b>   | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>7. Ilir Toska</b>        | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>8. Alban Toro</b>        | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>9. Brikena Ukperaj</b>   | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>10. Erjon Muharremaj</b> | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>11. Marçela Shehu</b>    | <b>(anëtare)</b>         |

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Helena Papa, Drejtoreshë e Kabinetit pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Pjerin Prendi, Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
4. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë institucionit.*
5. *Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë institucionit.*
6. *Valbona Bako, Specialiste pranë institucionit.*
7. *Elis Kuçi, Specialist pranë institucionit.*
8. *Edlira Bako, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
9. *Marjana Papa, OSCE.*
10. *Armand Sokoli, KSHH.*
11. *Gregor Borgowski, EURALIUS.*
12. *Klodian Rado, EURALIUS.*
13. *Valbona Bala (Pajo), USAID.*
14. *Charles Ericksen, USAID.*
15. *Ervin Karamuço, ISP.*

#### **RENDI I DITËS:**

4. Të tjera - Shqyrtimi i projektvendimit për një ndryshim në vendimin nr. 12, datë 18.01.2019 “Për miratimin e strukturës organizative të administratës së këshillit të lartë gjyqësor”, i ndryshuar.

*Naureda Llagami:* Kalojmë tek çështja e fundit e rendit të ditës.

Në fakt unë e kam shkruar me ‘Të tjera’ sepse ishte një situatë që ne e vendosëm dje që ta reflektonim dhe ta përfshinim tek rendi i ditës.

Sikurse ju kam bërë me dije, më së fundi qeveria ka alokuar Këshillit të Lartë Gjyqësor buxhetin dhe në frymën e zbatimit të buxhetit, konstatoam që tek struktura që ne kemi hartuar dhe miratuar së bashku, kishim disa pasaktësi lidhur me terminologjinë e bërë nga VKM-të e qeverisë lidhur me kategorizimin e pagave, por

edhe disa pasaktësi për sa i përket pozicioneve të punës, ndoshta pasaktësi për shkak të gabimeve të bëra nga ne në pjesën e hartimit të këtij projekt-akti.

Më konkretisht, unë dëshiroj t'ju sjellë në vëmendje që sipas strukturës organizative të miratuar me mbledhjet tona të datës 18 janar dhe në datën 12 mars, pa ndryshuar numrin e përgjithshëm të administratës, i cili sikurse na e ka miratuar Kuvendi dhe e konfirmuar edhe në strukturën tonë është 125 punonjës, duke propozuar reflektimin/pakësimin e numrit të punonjësve të dy sektorë dhe shtimin e tyre në dy sektorë të tjerë. Më konkretisht: është shtuar në Sektorin e Financës, një pozicion për funksionin e “Magazinierit”, duke e pakësuar në Sektorin e Standardeve dhe Infrastrukturës së IT. Pra neve, gjatë hartimit tonë të strukturës kishim harruar që të përfshinim në pozicion Magazinierin, pozicion i cili aktualisht është në Këshillin e Lartë të Drejtësisë (*Këshillin e Lartë Gjyqësor*), por për shkak të gabimeve tona njerëzore, ky pozicion nuk ishte përfshirë në pjesën e emërtimeve të pozicioneve.

E dyta është ndarja e funksionit të “Shoferit” të Kryetarit të KLGJ-së, nga ai i Anëtarit të KLGJ-së, pasi në miratimin e mëparshëm ka qenë vetëm “Shofer Anëtari KLGJ-së”.

Së treti, duhet saktësuar emërtimi i punonjësit “Receptionist”, me emërtimin sipas funksionit “Nëpunës Informacioni”, detyrim që na vjen nga VKM-ja për kategorizimin e pagave.

Është shtuar gjithashtu në Sektorin e Shërbimeve Administrative, një pozicion për funksionin e “Shoferit”, duke e pakësuar atë në Sektorin e Administrimit Gjyqësor dhe Standardeve. Kjo shtesë është bërë duke kuptuar dinamikën që ka Këshilli i Lartë Gjyqësor për shkak të vetingut dhe punës që zhvillon nëpër rrethe, që për institucionin është e domosdoshme që të jenë shoferë që do të veprojnë edhe jashtë Tiranës.

Ky është propozimi. Nëse keni diskutime edhe komente.

Ju sjell në vëmendje që zbatimi i projektbuxhetit dhe strukturës tonë do fillojë shumë shpejt tashmë dhe pikërisht, në kuadrin e marrjes së veprimeve për të zbatuar, janë konstatuar këto pasaktësi. Brenda numrit të përgjithshëm që ne kemi miratuar dhe brenda organigramës që ne bashkë kemi dakordësuar dhe miratuar në mbledhjet. Nëse keni ndonjë sugjerim ose ndonjë koment, ju lutem më thoni.

***Erjon Muharremaj:*** Faleminderit!

Referuar organigramës së re që na është paraqitur, unë nuk jam dakord me pakësimin e një anëtari të personelit në Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit dhe të Menaxhimit të Çështjeve për vetë rëndësinë e madhe që do të ketë kjo drejtori në punën e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të gjithë sistemit gjyqësor në tërësi. Duke marrë parasysh gjithashtu edhe faktin që është duke u diskutuar një projektvendim i Këshillit të Ministrave për ngritjen e qendrës së teknologjisë së informacionit, që sipas projektit, si do të ngrihet pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, dyfishohet rëndësia e kësaj drejtorie. Prandaj, në gjykimin tim, nuk do të ishte pozitive për veprimtarinë e Këshillit dhe sistemit gjyqësor në tërësi, pakësimi i një anëtari të personelit në këtë drejtori. Do të propozoja që të shqyrtohej mundësia e bërjes së rregullimit në kuadër të një strukture tjetër, për vetë rëndësinë që ka Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit. Faleminderit!

***Naureda Llagami:*** Faleminderit, zoti Muharremaj!

Ndonjë koment tjetër keni, që të mundohem të sqaroj edhe një herë pse është bërë kjo zgjedhje?

Atëherë, në kuptimin e propozimeve të bëra, nga grupi i punës që është marrë me zbatimin e strukturës, ka disa rregulla në mënyrën se si funksionon struktura. Ne jemi në pamundësi për të ndryshuar organigramën sepse është një vendim i Këshillit dhe nëse neve duhet ta ndryshojmë organigramën, duhet të shqyrtojmë edhe një herë dhe duhet të fillojmë edhe një herë procesin dhe të mendojmë edhe një herë për mënyrën e vendosur.

Nga ana tjetër, ju sjell në vëmendje, që të vetmit sektorë në të cilën ne gjykojmë dhe menduam që kishim mundësi të lëvizim staf pa ndryshuar strukturat përkatëse, kur them për strukturën, flas për sektorët, ishte sektori i Teknologjisë dhe një sektor tjetër të Standardeve, pasi në këto dy sektorë, këto dy njësi ishin të përbërë nga 1+3, që do të thotë nga 1 përgjegjës dhe nga 3 specialistë. Vetëm në këtë mënyrë ne mund të bënim lëvizje.

Me gjithë dëshirën e mirë, sepse unë ndaj të njëjtin shqetësim, ashtu siç tha edhe zoti Muharremaj, për të cilën forcimi i Drejtorisë së Teknologjisë është një

prioritet jo vetëm për Këshillin por për gjyqësorin, ishim në pamundësi në këto momente që të bënim lëvizje në sektorë të tjerë, sepse nëse ne bënim lëvizje, nuk do na qëndronte struktura, në kuptim të detyrimeve ligjore që jep VKM-ja se si hartohet një strukturë. Që do të thotë, nuk mundet dot të ekzistojë një sektor me një përgjegjës dhe një anëtar, një specialist. Sikurse nuk mundet dot të ekzistojë një drejtori e sheshtë me një drejtor dhe me dy apo tre specialistë. Pra këto janë gjithë kufizimet që na jep legjislacioni përkatës për mënyrën se si ne hartojmë strukturën dhe e kemi menduar, e kemi studiuar shumë thellë mundësinë dhe e kuptuam që ishim në kushte pamundësie për të bërë gjëra të tilla.

Nga ana tjetër, ju sjell në vëmendje që edhe lidhur me krijimin e sektorëve apo me rekrutimin e stafit të ri, unë do ju sjell në vëmendje që KLGJ-ja fillimisht do merret me pjesën e transferimit të stafit ekzistent që punon pranë KLGJ-së në pozicionet e reja dhe më pas në hapjen e vendeve të reja vakante. Që do të thotë që rreziku që kemi ne me dy pozicione që ne ju propozojmë është që ato dy persona që dalin pa punë. Nuk ka qenë kurrë vullneti i KLGJ-së që stafi aktual të ngelet pa punë, përkundrazi unë si Kryetare e KLGJ-së që kam edhe një kontakt të drejtpërdrejtë me stafin aktual, jam shumë e lumtur dhe shumë e kënaqur me punën që ato bëjnë, në situata emergjente që ne jemi. Prandaj masat që unë kam propozuar janë masa imediate, janë masa të cilat nuk kemi ku të lëvizim, duhet t'i marrim, me idenë që mos t'i nxjerrim njerëzit pa punë dhe për më tepër që i duhen institucionit.

Lidhur me pjesën e IT-së unë kam të njëjtin shqetësim si e parashtruat ju. Unë jam e bindur që IT-ja nga niveli 2 që kemi tani (dy IT), në nivelin 6 + 1, kuptohet që do kemi një rritje cilësore, por ju sjell në vëmendje që jemi në qershor. Në dhjetor ne do bëjmë prapë strukturën dhe sa mbaron pjesa e transferimit, do kemi mundësi që ne ta shtojmë numrin e IT-së pa prekur në propozimet e strukturës për 2020-ën. Ndonjë gjë tjetër?

***Erjon Muharremaj:*** Faleminderit!

Në lidhje me pjesën e fundit të sqarimeve tuaja - faleminderit, për pjesën tjetër të sqarimeve - por për asnjë moment unë nuk sugjeroj që të largohet dikush nga puna. Në kushtet kur jemi diçka mbi 70 personel dhe do të bëhemi 125, jo vetëm që nuk ka

nevojë që të largohen nga puna, por do merren njerëz të tjerë nga puna. Në asnjë mënyrë, unë nuk kërkoj që stafi aktual të largohet. Propozimi im është që shtesat që do të bëhen të jenë një person më pak në sektorët e tjerë, në mënyrë që të mos preket sektori i IT-së, -për të sqaruar atë që thashë më parë. Faleminderit!

*Naureda Llagami:* Hedhim në votim.

*Maksim Qoku:* Dakord.

*Brunilda Kadi:* Dakord.

*Dritan Hallunaj:* Pro.

*Illir Toska:* Dakord.

*Alban Toro:* Dakord.

*Fatmira Luli:* Pro.

*Marçela Shehu:* Dakord.

*Erjon Muharremaj:* Kundër.

*Brikena Ukperaj:* Pro.

*Medi Bici:* Pro.

*Naureda Llagami:* Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi miratimin e ndryshimeve në vendimin nr. 12, datë 18.01.2019 “Për miratimin e strukturës organizative të administratës së Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i ndryshuar, sipas strukturës dhe skemës bashkëlidhur këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nëse s’keni ndonjë sugjerim, koment tjetër, unë mbledhjen e konsideroj të mbyllur.

\* \* \*

(Pika 4 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**